



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I81-2 Prot.

Tiranë 3/11/2025

Nr. Dok. 202503635/2

Lënda: Rekomandim për inspektimin e bërë në ambientin e shoqërimit në
Komisariatit e Policisë në Shijak

Drejtuar : Z. Ilir PRODA
Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

TIRANË

Z. Vilson BALA
Drejtorisë Vendore të Policisë

DURRËS

Z. Ilia MUÇA
Komisariatit të Policisë Shijak

SHIJAK

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatit e Policisë Shijak më datë 09.10.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatit e Policisë Shijak.

Inspektimi u krye sipas Planit Vjetor Inspektimi të MKPT-së të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit të inspektimit ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024 "*Për Policinë e Shtetit*", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të

Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11.2023 për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”* dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, mjedise ku mbahen e trajtohen shtetasit që iu është privuar liria, grupi i inspektimit u takua me Shefin e Komisariatit Shijak z. Ilia Muça, i cili u vu në dijeni në lidhje me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, z. Muça raportoi për grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në lidhje me masat e marra për përmirësimin e ambientit të shoqërimit, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në procedurat standarde dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Grupi i punës në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, të gjitha zyrat e punës të punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Në Komisariatin e Policisë Shijak, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera për këqyrjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi që iu bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisariat ishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, të gjitha provat e administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve si dhe materialet e tjera të ndryshme ndodheshin në këtë ambient.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se¹:

1. **Nuk ishin marrë masat** nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për krijimin e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe dhomës së intervistimit të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore, së bashku me sistemin e monitorimit të instaluar në to.
2. **Nuk ishin marrë masat** për krijimin e një zyre të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
3. **Nuk ishin marrë masat** për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit. Kjo masë të plotësohet menjëherë.
4. **Nuk ishin marrë masat** për shtimin e numrit të psikologëve që ofrojnë shërbimin pranë kësaj Drejtorie dhe komisariateve në varësi të saj në mënyrë që, të garantohet sa më parë psikologu në rajonet e policisë në rastet e të miturve në konflikt me ligjin, sipas nenit 18 pika 3 të ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”, prania e psikologut synon që të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar t’i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t’i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:

1. **Ishin marrë masat** për ndërtimin brenda ambienteve të shoqërimit ose ngjitur me to, të tualeteve të ndara më vete për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.
2. **Ishin marrë masat** për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e institucionit ashtu në ambientet e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Shijak.
3. **Ishin marrë masat** për plotësimin e të gjitha rubrikave të proces-verbalit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar sipas kërkesave të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

¹ Rekomandim nr. K4/I48-2 prot., datë 27.09.2024 “Rekomandim për inspektimin e bërë në ambientin e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Shijak.”

Ndërkohë që në ambientin e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Shijak, vazhdonin të ishin të pranishme mjaft problematika, të cilat do t'i paraqesim si më poshtë.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisaratin e Policisë Shijak është i ndërtuar pjesërisht sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit.²

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të institucionit dhe përbëhej nga 3(tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete, 1(një) dhomë shoqërimi për burra, 1(një) dhomë për gra dhe 1(një) dhomë për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, të pajisura me tavolina dhe stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x4m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral dhe ishin të siguruara me skarë hekuri me shufra vertikale dhe horizontale. Të treja dhomat gjithashtu kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik, dyert ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t'u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi të 3 dhomat ishin të pastra, nga ana higjieno-sanitare. Përgjatë inspektimit konstatuam se në dhomat e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohje/ftohje.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodheshin dy tualete të ndara më vete për gratë dhe burrat, të pajisura me çezmë dhe kishin ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë pa ndërprerje. Tualetet plotësonin kushtet higjieno-sanitare, ishin të lyera dhe të dezinfektuara.

Ambienti i shoqërimit në këtë komisariat ishte pajisur rishtazi me sistem monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit.

Në procedurën standarde të punës është përcaktuar se, të gjitha ambientet e dhomave të shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përfshirë tualetin) si ambienti i brendshëm i dhomave të shoqërimit, korridori i tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit.

² Pika 4 e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”. e.1 Në njësitë vendore policore ndërtohen ambientet e shoqërimit të ndara më vete për personat madhorë, të mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20 m² secila.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervista lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë.

Në Komisariatit të Policisë Shijak, gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 9.10.2025 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit 186 persona. Gjatë verifikimeve të regjistrave për periudhën e cituar me lart ishin shoqëruar 178 shtetas burra, 5 shtetase gra dhe 3 të mitur në konflikt me ligjin.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2025 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Në korridor dhe brenda në dhomat e shoqërimit, ishin afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, si dhe personave të ndaluar/arrestuar, të cilat ishin të aksesueshme nga këta persona edhe në gjuhë të huaj.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatit të Policisë Shijak nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë të Durrës.

Regjistri për evidentimin e personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve, gjatë veprimeve që kryen policia

Në Komisariatit të Policisë Shijak, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, sipas procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2024 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, regjistri ishte i sekretuar dhe rubrikat e tij ishin plotësuar nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Në këtë komisariat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Nga këqyrja e *“Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar”*, konstatuam se në disa nga këto procesverbale shoqërimi ishin plotësuar në të gjitha rubrikat, sipas parashikimeve të lidhjes *“Model nr.3”*, të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

Në Komisarlatin e Policisë Shijak personat e shoqëruar kishin akses në ujë pijshëm në çdo kohë ndërsa dhe nga verifikimi i regjistrave të personave të shoqëruar, koha mesatare e qëndrimit në komisariat varionte nga 1-5 orë.

Në zyrën e informacionit të Komisarlatit të Policisë Shijak ishte hapur një regjistër më vete për evidentimin e të dhënave të personave të mitur të shoqëruar, në bazë dhe të rekomandimit të Avokatit të Popullit për këtë qëllim³. Për vitin 2025 ishin evidentuar të dhënat për 3 persona të mitur.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar i cili ishte i sekretuar. Nga kontrolli i këtij regjistri nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë/ankesë. Plotësimin e këtij regjistri Avokati i Popullit e cilëson si një proces të rëndësishëm lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, për këtë arsye duhet të ketë një vëmendje të shtuar nga punonjësit për regjistrimin e kërkesave apo ankesave nga personat e privuar nga liria.

Për sa më lart, sjellim edhe njëherë në vëmendjen tuaj, si dhe bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, në Kreun VI *“Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar”*, parashikohet se *“Në të gjitha rastet e shoqërimeve, punonjësit e policisë janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë të drejtat e personave të shoqëruar, si dhe japin siguri për jetën, shëndetin, kushtet e qëndrimit dhe trajtimin human në këto ambiente”*, si dhe më konkretisht në pikën 1.1. *“Personat e shoqëruar kanë këto të drejta që jua njeh ligji: Të paraqesë kërkesa apo ankesa për mënyrën e shoqërimit, mbajtjes, trajtimin dhe respektimin të të drejtave nga personeli policor gjatë shoqërimit dhe mbajtjes në ambientet e policisë”*.

Ambientet e intervistimit

³ Rekomandim nr. 437 prot., datë 11.10.2019 *“Për garantimin e të drejtave të të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur”*.

Në Komisarlatin e Policisë Shijak, **nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin/ marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë.** Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit⁴: Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin dhe fiksimin e deklarimeve por edhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare.

KPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personave të shoqëruar në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme si nga e vetë punonjësit të policisë së shtetit ashtu edhe nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve.

Gjithashtu, edhe intervistimi apo marrja në pyetje e të miturve në konflikt me ligjin që shoqërohen në mjediset e këtij komisarati, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në ambiente të veçanta, sikurse është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde⁵. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues të të miturit.

⁴ electronic recording of police interviews, fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

⁵ Kreu VII. Pika 2.1/k e procedurës standarde thuhet se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Grupi i inspektimit konstatoi se në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në mungesë të tyre, u intervistuan punonjësit e policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, ku rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej asistencë ligjore apo mbrojtja me avokat kryesisht.

Përgjatë inspektimit në komisariatit e policisë Shijak, u konstatua se kishte një listë të afishuar në ambientet e komisariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht, gjithashtu ishin evidentuar në regjistrin e informacionit kur avokatët kryesisht kishin qenë të pranishëm. Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023, KPT-ja bën rekomandime për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohej gjithashtu veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. KPT-ja gjatë vizitës në organet e policisë së Shtetit ka konstatuar se: “Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”⁶.

Përgjatë inspektimit punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut, por për këtë komisariat ishte i disponueshëm vetëm psikologu i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, punonjësit e policisë lajmëronin urgjencën dhe i shoqëronin ata në Qendrën Shëndetësore Shijak, për të marrë ndihmën mjekësore.

Ndërkohë, u konstatua se në këtë Komisariat zbatohet detyrimi i përcaktuar në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të

⁶ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për krijimin e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe dhomës së intervistimit të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore, së bashku me sistemin e monitorimit të instaluar në to.
2. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Shtetit për krijimin e një zyre të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
3. Marrjen e masave nga Komisariati i Policisë Shijak për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
4. Marrjen e masave nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës për shtimin e numrit të psikologëve që ofrojnë shërbimin pranë kësaj Drejtorie dhe komisariateve në varësi të saj në mënyrë që, të garantohet sa më parë psikologu në rajonet e policisë në rastet e të miturve në konflikt me ligjin, në zbatim të nenit 18 pika 3 të ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Një kopje e gjetjeve e detyrave të lëna në këtë rekomandim të përgjithësohet edhe me punonjësit e nivelit bazë.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI
d.v**